



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 374/Prot.
5

Tiranë, më 15.6. 2016

REKOMANDIM

Nr. 12 datë 15/6 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.05.2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit *Spitalit Rajonal Lezhë*, me formë ligjore të aktivitetit person juridik,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 64, datë 18.03.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 29.04.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ, pranë kontrolluesit *Spitalit Rajonal Lezhë*, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit *Spitali Rajonal Lezhë*, i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin pjesë e grupit të punës, që titullari i kontrolluesit kishte formatuar për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga kërkesat e objektit të Urdhrit Nr.64, datë 18.03.2016, të Komisionerit "*Për kryerjen e hetimit administrativ*", që do të ushtrohet pranë këtij kontrolluesi.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi ka një rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e spitalit, miratuar në vitin 2012, nga Ministria e Shëndetësisë;
2. Kontrolluesi është në proces hartimi të rregullores mbi përpunimin e të dhënave personale;

3. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”. Konstatohet se ruajtja e konfidencialitetit nuk parashikohet as në kontratën e punës të punëmarrësit;
4. Kontrolluesi nuk ka marrë masa teknike të përshtatshme për ruajtjen e dosjeve fizike të pacientëve. Arshiva është e ndarë në disa ambiente të ndryshme (3), dy prej të cilave në kushte jo normale për ruajtjen e kartelave mjekësore. Konstatohet se ka mungesë të masave të sigurisë për dosjet fizike të pacientëve, të cilat janë të pasistemuara dhe në ambiente me parametra jo të duhura për ruajtjen e dokumentacionit. Për gjendjen aktuale në këto arkiva, flasin pamjet e marra në vend. Shpërndarja e kartelave në ambiente të ndryshme, disa dhe larg territorit të spitalit, mospërqëndrimi brenda territorit të tij, krijon vështirësi në aksesin e pacientëve për të dhënat e tyre shëndetësore.
5. Regjistrimi i pacientëve kryhet në mënyrë manuale (dosje fizike), dhe elektronike nëpërmjet sistemit e-Health. Ky sistem aksesohet online dhe serveri është i vendosur pranë AKSHI-t. Sistemi menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë e cila realizon edhe trajnimin e punonjësve, dhënien e aksesit etj.;
6. Konstatohet se në ambientet e kontrolluesit funksionon Telemedicina si projekt pilot i USAID-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Në funksion të kësaj veprimtarie realizohet një aplikacion i bazuar në “web”, në të cilin ngarkohen të dhënat e pacientëve dhe që konsultohen online nga mjekë të autorizuar.
7. Konstatohet se kontrolluesi ka një sistem video-survejimi (CCTV), i cili administrohet nga punonjësit e brendshëm të teknologjisë dhe informacionit. Konstatohen tabela informuese në hyrje të ambienteve të mbikëqyrura, por jo sipas formatit standard të miratuar në Udhëzimin Nr. 3 të Komisionerit;

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe akteve të Komisionerit.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

- Kontratë me punëmarrësin;
- Rregullore bazë e funksionimit të *Spitalit Rajonal Lezhë*;
- Projekt rregullore (standardi i Zyrës së Komisionerit), për mbrojtjen e të dhënave personale, e cila po modifikohet në funksion të veprimtarisë së kontrolluesit;
- Pamje/foto nga ambientet e kontrolluesit dhe sistemi CCTV;
- Kartelë klinike pacienti
- Formular Njoftimi.

Në datë 03.05.2016, u mbajt procesverbal nga ana e grupit të Inspektimit të Zyrës së K.D.I. M.D.P-së, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit *Spitalit Rajonal Lezhë*, në zbatim të kërkesave të Urdhrit Nr.64, datë 18.03.2016 të Komisionerit.

Procesverbali pasi u lexua nga të pranishmit ju dorëzua titullarit të kontrolluesit, i cili u shpreh: *“Mora dijeni për konstatimin e grupit të auditimit e për këtë qëllim ngritëm grupin e punës, për përmbushjen e konstatimeve të mësipërme”*.

Me shkresën Nr.179/5, datë 07.06.2016, kontrolluesi *Spitali Rajonal Lezhë*, ka vënë në dijeni Zyrën e Komisionerit, për masat e marra në realizimin e detyrimeve të dala nga procesverbali i grupit të inspektimit.

Në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, datë 30.04.2015, në datë 13.06.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me pretendimet që kontrolluesi mund të ketë, në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesi i kontrolluesit, nuk shprehu pretendime por paraqiti, Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Rregullore për Sistemin e Video Survejimit në Spitalin Rajonal Lezhë, Deklaratat e Konfidencialitetit të punëmarrësve, standardizimin e tabelës së informimit dhe solli fakte se kishte filluar sistemimi i ambienteve të arshivës sipas parametrave të duhur, duke përmbushur detyrimet që dalin nga ligji dhe konkretisht nga Urdhri Nr.64, datë 18.03.2016 i Komisionerit.

Shqetësimi që solli në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit, në lidhje me mosbindjen e disa punëmarrësve, për mos nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit përbën një shkelje të rëndë jo vetëm të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, por dhe të Kodit të Punës. Mbrojtja e të dhënave personale, është një proces pune, dhe si i tillë përveç të drejtave që ka një punëmarrës, ka dhe detyrime, mosprëmbushja e të cilave passjell sanksione. Në gjithë përvojën e Zyrës së Komisionerit, është i pari rast, e ndoshta do të mbetet i vetmi, ku punëmarrësit nuk nënshkruajnë Deklaratën e Konfidencialitetit, si një detyrim ligjor gjatë ushtrimit të detyrës.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, ndryshe nga kontrollues të tjerë, janë rikuperuar brenda një afati kohor relativisht të shkurtër, si dhe bashkëpunimi i kontrolluesit me grupin e hetimit ka qenë serioz dhe në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e shëndetësisë,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, kontrolluesi *Spitali Rajonal Lezhë*, të realizojë kushtet normale në arkivimin e kartelave mjekësore të pacientëve, si dhe të mundësojë përqendrimin e tyre, në funksion të personelit mjekësor administrativ dhe subjekteve të të dhënave personale, pacient.

2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe Vendimit Nr.6, datë 03.08.2012 të Komisionerit, kontrolluesi të pajisë me Deklarata Konfidencialiteti të gjithë punëmarrësit që aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Në rast të kundërt, me tagrin që ka titullari i kontrolluesit, të procedojë sipas sanksioneve të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.
3. Kontrolluesi, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, duhet t'i realizojë brenda një afati kohor, prej 60 ditësh për pikën e parë, dhe brenda një afati kohor prej 20 ditësh për pikën e dytë të këtij rekomandimi.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 15.6.2016

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI
